



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

**FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESES PER TATIMIN
NË TË ARDHURAT PERSONALE**

UNIREF

PD

[1] Periudha e Deklarimit:

[3] Numri Fiskal: [3a] Numri Personal:

[4] Emri i tatimpaguesit:

[5] Adresa e tatimpaguesit:

[6] Telefoni:

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.

Shtesë

Korigjim

Vetëm pagesë

[47] Shuma obligative (Barteni shumën nga kutia [42])

[48] Shuma e tatimit të paguar

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë deklaratë tatimore janë të vërteta.
Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe Vula

(_____)

Data:

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula	Numri i llogarisë: 1000420070000373	[49] Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data: ___/___/_____	

Të ardhurat e tatueshme

[8] Pagat bruto.....	[8]	
[9] Të ardhurat neto nga biznesi nga kutia 78 e DF.....	[9]	
[10] Të ardhurat neto nga ortakëritë.....	[10]	
[11] Qiratë bruto.....	[11]	
[12] Të ardhurat bruto nga pagesat e pensionit.....	[12]	
[13] Të ardhurat bruto nga interesi.....	[13]	
[14] Të ardhurat bruto nga fitoret në lotari	[14]	
[15] Të ardhurat bruto nga pasuria e patrupëzuar.....	[15]	
[16] Fitimet kapitale.....	[16]	
[17] Të ardhurat me burim nga jashtë.....	[17]	
[18] Të ardhura tjera përfshire dhuratat (specifiko llojin e te ardhures).....	[18]	
[19] Totali i të ardhurave (shto 8 deri 18).....	[19]	

Zbritjet

[20] Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e qirasë-reale ose 10% të qirasë bruto.....	[20]	
[21] Shpenzimet për kontributet pensionale (bashkëngjijt dokumentet).....	[21]	
[22] Shpenzimet që lidhen me të ardhurat nga pasuria e patrupëzuar.....	[22]	
[23] Shpenzimet tjera të lejueshme (specifiko)	[23]	
[24] Totali i shpenzimeve të lejuara (mblidh 20 deri 23).....	[24]	
[25] Shuma e tatueshme (19-24) - Nëse është negative vendos shumën në kllapa.....	[25]	

Tjera

[26] Humbjet e bartura	[26]	
[27] Zbritja për kontributet bamirëse (5% të vlerës së tatueshme), nuk është e deklaruar në DF...[27]	[27]	
[28] Totali i zbritjeve tjera (26+27).....	[28]	
[29] Të ardhurat e tatueshme para tatimit [25]-[28] Nëse është negative vendose shumën në kllapa.....	[29]	
[30] Tatimi në të ardhurat e tatueshme sipas grupeve tatimore (Nëse është negative vendose 0).....	[30]	

Tatimi i mbajtur në burim gjatë vitit

[31] Tatimi i mbajtur në burim në paga nga punëdhënësit (bashkëngjijt certifikatat)	[31]	
[32] Tatimi i mbajtur në burim mbi interesin (bashkëngjijt certifikatat).....	[32]	
[33] Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë (bashkëngjijt certifikatat).....	[33]	
[34] Tatimi i mbajtur në burim mbi fitoret në lotari (bashkëngjijt certifikatat)	[34]	
[35] Kreditimi i tatimit te huaj (bashkëngjijt certifikatat).....	[35]	
[36] Totali i tatimit të mbajtur në burim dhe kreditimi (31 deri 35).....	[36]	
[37] Tatimi Total i pagueshëm për periudhën [30]-[36].....	[37]	
[38] Pagesat tremujore paradhënie mbi të ardhurat nga biznesi.....	[38]	
[39] Pagesat tremujore paradhënie mbi të ardhurat nga qiraja dhe pasuria e patrupëzuar...[39]	[39]	
[40] Totali i pagesave paradhënie për periudhat[38] + [39].....	[40]	
[41] Totali i tatimit për pagesë [37]- [40].....	[41]	

Nëse rezultati në kutinë [41] është (+) ju keni një shumë obligative. Nëse rezultati në kutinë [41] është (-) ju keni një rimbursim. Vendos shumën në kutinë e duhur.

[42] Shuma obligative

[43] Rimbursimi

[44] Emri i bankës

[45] Bartësi i llogarisë.....

[46] Numri i llogarisë (shëno 16 shifra).....

Udhëzim rreth plotësimit të "Formulari i deklarimit vjetorë dhe pagesës për tatimin në të ardhurat personale"

Viti Tatimor 2010

Kush ka për obligim ta dorëzojë këtë deklaratë

- Bizneset e mëdha individuale,
- Bizneset individuale të cilat në mënyrë vullnetare kanë zgjedhur opsionin e tatuarjes në baza reale,
- Ortaket që kanë qarkullim mbi 50,000 € ose kanë zgjedhur opsionin e tatuarjes në baza reale,
- Çdo individ të cilit nuk i është mbajtur tatimi në burim,
- Çdo person i cili ka pasur dy apo më shumë burime të të ardhurash, dhe
- Çdo person i cili nuk ka pasur pagën konstante brenda periudhës tatimore

Të ardhurat e tatueshme

Kutitë [1]-[5]

Këto detaje gjenerohen automatikisht në formular. Kontrolloni saktësinë. Nëse jo, duhet t'i korrigjoni ato duke qenë prezent personalisht në zyrën e ATK-së.

Kutia [6] Shkruani numrin tuaj të telefonit, apo në rast se dikush ka pregaditur këtë formular, shkruani emrin dhe numrin e telefonit të atij personi.

Kutia [7] Nëse deklaroni këtë periudhë tatimore për here të pare, lëreni të zbrazët këtë këtë pjesë. Nëse e ndryshoni deklaratën paraprake, duhet të vendosni X në njerën nga tri kutitë e mëposhtme:

Shtesë - për të deklaruar të ardhura shtesë

Korrigjim - për të ndryshuar të dhënat e deklaruara më pare për atë periudhë

Vetëm pagesë - për të bërë pagesën shtesë për të ardhurat e deklaruara më pare.

Kutia [8] Vendos shumën e pagave bruto të realizuara gjatë periudhës tatimore.

Kutia [9] Nëse ka, vendose shumën e të ardhurave neto nga biznesi nga kutia [78] e Deklaratës për të Ardhurat dhe Shpenzimet. Nëse nuk keni asgjë për të deklaruar në këtë kuti apo ndonjë tjetër, lëreni të zbrazët.

Kutia [10] Vendose shumën e të ardhurave neto të marra nga ortakëritë të marr nga rubrika [31] e Deklaratës së Ortakërisë, nëse ka.

Kutia [11] Vendos shumën e të ardhurave bruto nga qiraja gjatë periudhës tatimore, nëse ka.

Kutia [12] Vendos shumën e të ardhurave bruto të realizuara nga pensionet gjatë periudhës tatimore.

Kutia [13] Vendos shumën e interesit bruto të realizuar gjatë periudhës tatimore.

Kutia [14] Vendos shumën e të ardhurave bruto nga fitoret në lotari të realizuara gjatë periudhës tatimore.

Kutia [15] Vendos shumën bruto nga pasuria e patrupëzuar të realizuara gjatë periudhës tatimore.

Kutia [16] Vendos shumën e të ardhurave bruto nga fitimet kapitale të realizuar gjatë periudhës tatimore.

Kutia [17] Vendos shumën e të ardhurave bruto të realizuar nga jashtë.

Kutia [18] Vendos shumën e të ardhurave tjera përfshirë dhuratat (të specifikohen të ardhurat)

Kutia [19] Mblidh shumën e të ardhurave bruto duke mbledhur kutitë [8] deri [18].

Zbritjet

Kutia [20] Vendos shumën e shpenzimeve të qerasë gjate periudhës tatimore. Këto duhet te jene ose ato reale (nëse janë mbajtur libra dhe regjistrime te duhura) ose 10% te të ardhurave bruto nëse nuk janë mbajtur libra dhe regjistrime.

Kutia [21] Vendos shumën e kontributit pensional të bërë nga tatimpaguesi individual në emër te vetin (bashkëngjiti certifikatën)

Kutia [22] Vendos shumën e shpenzimeve të dala nga gjenerimi i të ardhurave nga pasuria e patrupëzuar.

Kutia [23] Vendos shpenzimet tjera të cilat janë të lejueshme (specifiko).

Kutia [24] Vendos shumën totale nga rubrika [20] deri [23].

Kutia [25] Zbriti: Kutinë [19] -Kutinë [24]. Vendos atë shumë këtu. Nëse është negative, vendose shumën në kllapa.

Kutia [26] Vendos humbjet e bartura nga periudhat tatimore të kaluara, nëse e aplikueshme.

Kutia [27] Vendos shumën e kontributeve bamirëse të bëra gjatë periudhës tatimore. Kjo nuk duhet të tejkaloj 5% të shumës së cekur në kutinë [9],

dhe kjo dispozitë është e aplikueshme vetëm për ata individ që paguajnë tatimin mbi të ardhurat reale ose vendosin ta bëjnë mbi to, në rastin kur vlera e tatueshme është negative vendos 0.

Kutia [28] Vendos totalin e zbritjeve tjera nga rubrika [26]+[27].

Kutia [29] Zbritë kutinë [28] nga kutia [25]. Nëse negative, vendose shumën në kllapa.

Kutia [30] Llogarit detyrimin tatimor sipas grupimeve te të ardhurave te specifikuar ne nenin 6 të Ligjit Nr. 03/L-161 vetëm nëse shuma e vendosur ne [29] është një shume pozitive.

Nëse kutia [30] është...	...atëherë shkalla tatimore është:
960€ apo më pak	0%
960€ deri 3,000€	4% të shumës mbi 960€
3,000€ deri 5,400€	81.60€ plus 8% e shumës mbi 3,000€
Më shumë se 5,400€	273.60€ plus 10% e shumës mbi 5,400€

Shembull

E ardhura e tatueshme	Llogaritja	Tatimi
2,600€	2,600 - 960 = 1,640 x 4%	65.60€
4,800€	81.60 + (4,800 - 3,000 = 1,800 x 8%)	225.60€
22,000€	273.60 + (22,000-5,400 = 16,600 x 10%)	1933.60€

Tatimi i mbajtur në burim gjatë vitit

Kutia [31] Vendos shumën e tatimit të mbajtur ne burim mbi pagat nga punëdhënësi i juaj (bashkëngjiti certifikatën).

Kutia [32] Vendos shumën e tatimit mbi interesin të mbajtur në burim nga bankat ose institucionet tjera financiare gjate periudhës tatimore . (Bashkëngjiti kopjet e certifikatave).

Kutia [33] Vendos shumën e tatimit mbi qiranë të mbajtur në burim nga qiramarrësit jo individual. (Bashkëngjiti kopjet e certifikatave).

Kutia [34] Vendos shumën e tatimit mbi fitoret në lotari të mbajtur në burim nga organizatorët e lotarisë. (Bashkëngjiti certifikatën.)

Kutia [35] Vendos shumën e tatimit të paguar në shtete e huaja për të ardhurat e realizuara në ato shtete. (bashkëngjiti certifikatat nga autoriteti tatimor përkatës.)

Kutia [36] Mblidh kutitë [31] deri [35].

Kutia [37] Zbrit: Kutinë [30] - Kutinë [36] për të përcaktuar totalin e tatimit të pagueshëm.

Kutia [38] Vendos shumën totale të pagesave sipas tremujorëve si paradhënie për të ardhurat bruto gjatë vitit.

Kutia [39] Vendos shumën e tatimit të paguar mbi të ardhurat e qirasë dhe pasurisë së patrupëzuar gjatë periudhës tatimore.

Kutia [40] Mblidh kutitë [38] dhe [39].

Kutia [41] Zbrit: Kutinë [37] - Kutinë [40].

Nëse shuma është pozitive, vendose atë shumë në kutinë [42].

Nëse shuma është negative, vendose atë shumë në kutinë [43].

Kutia [42] Vendose shumën e papaguar të tatimit.

Kutia [43] Vendos shumën e tepërt të tatimit të paguar. Kjo paraqet reimbursim. Ju mund të kërkonit këtë shumë apo ta aplikoni për ndonjë periudhe tatimore, duke përfshirë periudhat e ardhshme. Nëse keni borxh, ATK-ja mund ta aplikojë atë shumë kundrejt borxhit.

Kutia [44] Vendos emrin e bankës

Kutia [45] Vendos emrin e mbajtësit të llogarisë

Kutia [46] Vendos numrin e llogarisë bankare në të cilën dëshironi reimbursimi të ju kreditohet.

Kutia [47] Shuma obligative e tatimit, barteni nga kutia [42].

Kutia [48] Vendos shumën e tatimit të paguar me këtë formular.

Kutia [49] Lëreni këtë pjesë të zbrazët. Arkëtarë i bankës do te vendos shumën e tatimit te paguar me këtë formular.

Deklarata Tatimore Vjetore duhet të nënshkruhet dhe t'i vihet data nga tatimpaguesi apo një person i caktuar nga ai dhe të dorëzohet në bankë më ose deri më 31 Mars të vitit që pason periudhën tatimore.

Ta keni parasysh se bankat mund të ju ngarkojnë me pagesë prej 1€.